

Në bazë të nenit 7 të Ligjit për kulturë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15 dhe 39/16) dhe nenit 10, 22 dhe 41 të Ligjit për Qytetin e Shkupit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 55/04),

QYTETI I SHKUPIT shpall

THIRRJE PUBLIKE

për grumbullimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2021 të dedikuara për financimin dhe përkrahjen e programeve dhe veprimtarive të institucioneve publike nga fusha e kulturës të themeluara nga Qyteti i Shkupit për vitin 2022

I

Qyteti i Shkupit do të marrë pjesë në financimin dhe përkrahjen e programeve dhe veprimtarive të institucioneve publike nga fusha e kulturës të themeluara nga Qyteti i Shkupit në fushat vijuese:

- 1.1. Arte performuese
- 1.2. Arte muzikore
- 1.3. Arte vizuale dhe arte të medimeve të reja
- 1.4. Veprimtari botuese dhe bibliotekare
- 1.5. Veprimtari muzeore dhe promovimi i trashëgimisë kulturore
- 1.6. Bashkëpunim ndërkombëtar

II

Qyteti i Shkupit do të marrë pjesë në financimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të institucioneve publike nga fusha e kulturës të themeluara nga Qyteti i Shkupit në pajtim me legjislacionin, në bazë të qëllimeve dhe kriterëve të përgjithshme vijuese:

- ruajtja dhe afirmimi i trashëgimisë materiale, shpirtërore dhe kulturore të qytetit të Shkupit;
- nxitja dhe afirmimi i shumëllojshmërisë dhe larmisë etnike në kulturë;
- inovacion, përshtypje dhe origjinaliteti i idesë;
- vazhdimësia e manifestimeve tradicionale kulturore – artistike, që janë me interes për qytetin e Shkupit;
- promovimi i trashëgimisë kulturore të qytetit të Shkupit;
- prezantimi dhe afirmimi i krijimtarisë bashkëkohore, kulturore urbane dhe artit publik;
- kujdesi për infrastrukturën publike në suaza të kulturës dhe stimulimi i medimeve të reja dhe hulumtimeve në fushën e kulturës;
- stimulimi dhe përkrahja e projekteve ndërkombëtare të partneriteteve të ndryshëm;

- përkrahja dhe zhvillimi i vlerave tradicionale kulturore;
- themelimi i bashkëpunimit në suaza të projektit të propozuar me një ose më shumë institucione kulturore dhe organizata;
- organizimi i festivaleve ndërkombëtare që mbahen në Shkup;
- kremtimi i evenimenteve jubilarë dhe datave me rëndësi në kulturë;
- publikim i librave dhe botimeve elektronike, monografive, përmbledhjeve që trajtojnë tema nga jeta dhe historia e Shkupit;
- projekte qëllimi i të cilave është zhvillimi dhe promovimi i fushave të kulturës dhe industrive kreative;
- realizimi i filmave dokumentarë që kanë të bëjnë me historinë dhe jetën bashkëkohore në qytetin e Shkupit;
- nxitje e mendimit shkencor dhe kritik përmes organizimit të seminareve, konferencave, debateve të cilat trajtojnë tema nga jeta dhe historia e Shkupit;
- bashkëpunim dhe pjesëmarrje në manifestimet, festivale dhe në projekte ndërkombëtare në bazë të reciprocitetit,
- programe dhe projekte nga fusha e kulturës që zhvillohen në territorin e qytetit të Shkupit dhe të cilat kanë siguruar mjete financiare (grante) nga fondet e Komisionit Evropian, UNESCO ose organizata të tjera ndërkombëtare;
- bashkëpunim dhe projekte me organizata, institucione dhe individë nga qytetet e vëllazëruara me Qytetin e Shkupit
<https://skopje.gov.mk/mk/apliciraj/javni-povici/> – lidhje me portalin zyrtar të Qytetit të Shkupit

III

Mjetet për financimin e veprimtarisë së institucioneve publike dhe programeve, manifestimeve dhe projekteve të tyre, përcaktohen me Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2022 dhe Programin vjetor për kulturë.

IV

Aplikimi për Thirrjen publike realizohet me dorëzimin e fletëparaqitjes së plotësuar (aplikacionit) në arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16). Fletëparaqitjet (aplikacionet) mund të merren në Sektorin për veprimtari publike-Seksioni për kulturë i Qytetit të Shkupit (baraka 2) ose nga ueb-faqja zyrtare e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

V

Thirrja publike zgjat nga data 01.09.2021 pikërisht, 30 ditë kalendarike nga dita e shpalljes në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk. Aplikacionet, në formë të shkruar dhe në formë elektronike në formatin WORD, duhet të dorëzohen në Qytetin e Shkupit, me postë në adresën: Bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup, ose në arkivin e Qytetit të Shkupit, deri në orën 15:00 në ditën e fundit të Konkursit (30.09.2021), me shënimin

„Thirrje publike për grumbullimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2022, të dedikuara për financimin dhe përkrahjen e programeve dhe veprimtarisë së institucioneve publike nga fusha e kulturës të themeluara nga Qyteti i Shkupit për vitin 2022“.

Rezultatet e Konkursit, me shpalljen e Programit të miratuar për financimin e programeve dhe projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2022, do të shpallen në “Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” dhe në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

Informacione plotësuese mund të merren në telefonat: 02/3297-324, 02/3297- 289 dhe e-mail adresën vijuese kultura@skopje.gov.mk.

QYTETI I SHKUPIT